

Prof. Aurela Anastasi.

Propozuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Departamenti i së Drejtës Publike.

Prof. Aurela Anastas është pedagoge dhe studiuese në lëmin e të Drejtës nga viti 1987; mban titullin “Profesor” nga viti 2005; është anëtare e Akademisë së Shkencave të RSH-së nga viti 2009; Avokate për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut nga viti 1996. Ajo është zgjedhur për dy mandate rresht përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Publike në Fakultetin e Drejtësisë, UT, ndërsa në periudha afatshkurtra është emëruar Zv. Dekane e këtij Fakulteti. Ka punuar pranë Departamentit të së Drejtës Publike për mësimdhënien dhe zhvillimin e disiplineve shkencore të së Drejtës Kushtetuese dhe të Historisë të së Drejtës. Është një nga themelueset dhe hartueset e lëndës “E drejta Kushtetuese e Krahasuar”, si dhe e disa prej disiplineve mësimore që zhvillohen në programet “Master” dhe “Doktoratë”.

Është autore dhe bashkautore e teksteve mësimore; ka botuar artikuj studimorë në revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare; ka realizuar referate e kumtesa në aktivitetet shkencore si brenda edhe jashtë vendit; ka ligjëruar si pedagoge vizitore në disa universitete jashtë vendit; është anëtare e redaksive botuese në disa revista shkencore; ka drejtuar dhe ka marrë pjesë në projekte studimore, kombëtare e ndërkombëtare, për zhvillimin e legjislacionit dhe të jurisprudencës. Ka qenë anëtare në disa komisione dhe ka drejtuar grupe pune në kuadrin e reformave kushtetuese e ligjore kombëtare. Ka drejtuar punën studimore e kërkimore për studentët dhe studiuesit e rinj. Ajo është iniciatore dhe drejtuese e disa aktiviteteve shkencore për të rinjtë juristë dhe e krijimit të organizatave pro bono të studentëve të fakulteteve të Drejtësisë, me qëllim ofrimin e ndihmës ligjore falas, për shtresat në nevojë.

Është pedagoge e jashtme dhe eksperte në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pranë Shkollës së Magjistraturës. Nga viti 2004 e në vijim është zgjedhur në forumet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe pedagoge pranë Shkollës Kombëtare të Avokatisë. Ajo është aktiviste e shoqërisë civile dhe ka drejtuar organizata të saj. Gjithashtu, ka përfaqësuar si avokate njerëz në nevojë në raste gjyqësore strategjike për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut e në veçanti, të drejtave të grave, të barazisë e mosdiskriminimit.

Është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Konstitucionalistëve (nga viti 2014), si dhe e disa rrjeteve shkencore ndërkombëtare. Ka qenë anëtare e “Komisionit Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit”, Komisionit të Venecias në emër të Shqipërisë (2016-2020).

Për aktivitetet që ka kryer, Aurela Anastas është vlerësuar me certifikata mirënjohjeje nga Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë (2020) dhe Universiteti Evropian i Tiranës (2022). Gjithashtu, ajo është nderuar me mirënjohje edhe nga disa organizata joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Prof. Aurela Anastasi

Proposed by the Faculty of Law at the University of Tirana, Department of Public Law.

Prof. Aurela Anastas is Member of the Academy of Sciences in Albania since 2009. Professor of Constitutional Law since 1987; Defense Attorney for the protection of human rights since 1996.

Prof. Aurela Anastas completed her studies in 1987 at the Faculty of Law, University of Tirana, after which she was appointed to this faculty. She has contributed to the Department of Public Law teaching and developing the research on Constitutional Law. In addition, she is the founder of the course "Comparative Constitutional Law" and of several other syllabuses in "Master" and "Doctorate" programs.

Prof. Aurela Anastas has conducted several postgraduate studies and was a Fulbright scholar at Boston College Law School (2017-2018). She is the author / co-author of several monographs and textbooks, as well as of numerous scientific articles and conference papers. She has lectured as a visiting lecturer at several universities abroad; has directed and coordinated several national and international scientific projects for the development of the legislation and jurisprudence in Albania. As a member of the editorial boards, she has contributed to Albanian scientific journals. She has chaired working groups in the framework of national legal reforms, such as the Constitutional Reform for the Justice system (2016), for the drafting of laws on gender equality in society, for protection against discrimination and domestic violence. Moreover, she has been among the drafters of agreements of religious communities with the Council of Ministers.

Prof. Aurela Anastas has also performed some important state and social tasks. She has been elected for two consecutive terms in charge of the Department of Public Law at the Faculty of Law (University of Tirana), while for a short term was appointed Deputy Dean and Dean of this Faculty. She is a guest lecturer and trainer in the ongoing training of judges and prosecutors at the School of Magistrates. She is a member of the International Association of Constitutionalists (since 2014) and of international scientific networks. She has been a member of the "European Commission for Democracy through Law" (Venice Commission), on behalf of Albania (2016-2020).

Prof. Aurela Anastas is a civil society activist and has served as a lawyer and leader in non-profit organizations. As an expert, she has represented civil society organizations before national and international institutions. She is the leader of several scientific activities for young lawyers and the creation of pro bono organizations of law students, to provide free legal aid to people in need. She has presented as a lawyer in strategic court cases for the protection of human rights and women's rights, equality and non-discrimination.

For the activities she performed, Aurela Anastas has received certificates of appreciation from the University "Ismael Qemali", Vlora (2019) and the European University of Tirana (2023). She was also awarded by several national and international non-governmental organizations.